

01-146



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të neni 21, 22, 44 dhe 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03, dt. 21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në detyrë zyrtare me datë, 08.08.2024, merr këtë:

V E N D I M

KORRIGJIM I AKTIT ADMINISTRATIV "VENDIM ÇAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE"
05NR.350/02-23500/23 DT.23.10.2023

I. Korrigjohet pjesa tekstuale e aktit adiministrativ "Vendim çaktimi i kushteve ndërtimore" 05nr.350/02-23500/23 dt.23.10.2023, i lëshuar nga kjo drejtori, në emër të kërkuesve: Pronarëve, Vebi Ibrahim, Gafurr dhe Gazmend Gosalci, Vahide Xhumshiti, Hasan Sylja, Bekim dhe Shemi Gashi dhe Investitorit, "BTP Holding" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 810693897, dhe me pronar Sabri Hasani nga Vushtrria, sipas kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 23500/23 dt.31.01.2023 dhe kërkesës për ndërhyrje në procedurë administrative, 05nr.350/02-52800/23 dt.10.03.2023, të kërkuesve: Pronarëve, Adem dhe Miradi Islami nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/ projektin kryesor për ndërtimin e pjesës së Kompleksi "BTP Rezidenca A" me ndërtesa shumëbanesore & afariste, përkatësisht – Ndërtesa "A1" me 2B+S+P+8, "B1" me 2B+S+P+8, "C1" me 2B+S+P dhe "D1" me 3B, (Grupi "1" / Faza "1") dhe Ndërtesa "MA" me 2B+S+P+7 (Grupi "2"), të gjitha këto në kuadër të parcelave ndërtimore të Bllokut Urban "A-19", Tërësia urbane "A" – ngastra ndërtimore "F", të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, nr.949-1, 953-0, 954-2, 954-3, 954-5, 954-7, 954-9, 954-14 ZK Matičan (Grupi "1"/Faza "1"), si dhe me trajtim përmes këmbimit të parcelës kadastrale nr.955-0 ZK Matičan, me pronar/ posedues PSH. KK Prishtinë, dhe të parcelave kadastrale nr.954-6, 833-5 dhe 833-22 ZK Matičan (Grupi "2"), si dhe me trajtim përmes këmbimit të pjesës së parcelës kadastrale nr.1411-1 ZK Matičan, me pronar / posedues PSH. Ujëra, sipas projekt propozimit konceptual & Planit të situacionit – "zgjidhja urbane".

II. Korrigjimi i aktit adiministrativ, nga paragrafi I, i këtij vendimi, bëhet në pjesën tekstuale të tij, përkatësisht në paragrafin VI, IX, XVI, dhe te pjesa e arsyetimit, dhe atë si në vijim:

- **Në paragrafin VI. (Këmbimi), në vend të tekstit:**

".....po ashtu edhe këmbimi i pjesës së parcelës nr.955-0 ZK Matičan, me S=106m², me pronar/ posedues PSH KK Prishtinë, e shtrirë brenda bllokut urban, me pjesën e parcelës kadastrale nr. 833-22 ZK Matičan, me S=106m², me pronar / posedues Adem Islami.....",

shënohet teksti:

".....po ashtu edhe këmbimi i pjesës së parcelës nr.1411-1 ZK Matičan, me S=106m², me pronar/ posedues PSH. Ujëra, e shtrirë brenda bllokut urban, me pjesën e parcelës kadastrale nr. 833-22 ZK Matičan, me S=106m², me pronar / posedues Adem Islami.....";

- **Në paragrafin IX. (Kompensimi / shpronësimi), në vend të tekstit:**

"Kompensimi / shpronësimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.955-0 ZK Matičan, do të realizohet pas zbatimit të paragrafit VI të kushteve ndërtimore"/

shënohet teksti:

"Kompensimi / shpronësimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.955-0 dhe nr.1411-1 ZK Matičan, do të realizohet pas zbatimit të paragrafit VI të kushteve ndërtimore";

- **Në paragrafin XVI. (Kushtet e veçanta), në vend të tekstit:**

"...dhe i pjesës së parcelës kadastrale nr. 955-0 ZK Matičan, me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, me pjesën e parcelës kadastrale nr. 833-22 ZK Matičan, me pronar / posedues Adem Islami";

shënohet teksti:

"...dhe i pjesës së parcelës kadastrale nr. 1411-1 ZK Matičan, me pronar / posedues P.SH. Ujëra, me pjesën e parcelës kadastrale nr. 833-22 ZK Matičan, me pronar / posedues Adem Islami".

- Te pjesa e "Arsyodim", në vend të tekstit:

"...me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, dhe 1nr. 411-1 ZK Matëan,..." dhe "...do të trajtojë parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale, nr.954-6, 833-5, 833-22 & 1411-1 ZK Matëan, të pronarëve, Adem dhe Miradi Islami nga Prishtina, si dhe KK Prishtinë,..."

shënohet teksti:

"...me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, dhe nr. 1411-1 ZK Matëan,..." dhe "...do të trajtojë parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale, nr.954-6, 833-5, 833-22 & 1411-1 ZK Matëan, të pronarëve, Adem dhe Miradi Islami nga Prishtina, si dhe PSH. Ujëra,..."

III. Ky vendim është pjesë përbërëse e aktit administrativ "Vendim caktimi i kushteve ndërtimore" 05nr.350/02-23500/23 dt.23.10.2023, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit.

Ar sy e t i m

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, gjatë përpilimit të aktit administrativ "aktit administrativ "Vendim caktimi i kushteve ndërtimore" 05nr.350/02-23500/23 dt.23.10.2023, në emër të kërkuesve: Pronarëve, Vebi Ibrahim, Gafurr dhe Gazmend Gosalci, Vahide Xhumshiti, Hasan Syla, Bekim dhe Shemi Gashi dhe Investitorit, "BTP Holding" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 810693897, dhe me pronar Sabri Hasani nga Vushtrria, sipas kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 23500/23 dt.31.01.2023 dhe kërkesës për ndërhyrje në procedurë administrative, 05nr.350/02-52800/23 dt.10.03.2023, të kërkuesve: Pronarëve, Adem dhe Miradi Islami nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/ projektin kryesor për ndërtimin e pjesës së Kompleksi "BTP Rezidenca A" me ndërtesa shumëbanesore & afariste, përkatësisht – Ndërtesa "A1" me 2B+S+P+8, "B1" me 2B+S+P+8, "C1" me 2B+S+P dhe "D1" me 3B, (Grupi "1" / Faza "1") dhe Ndërtesa "MA" me 2B+S+P+7 (Grupi "2"), të gjitha këto në kuadër të parcelave ndërtimore të Bllokut Urban "A-19", Tërësia urbane "A" – ngastra ndërtimore "F", të Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, nr.949-1, 953-0, 954-2, 954-3, 954-5, 954-7, 954-9, 954-14 ZK Matëan (Grupi "1"/Faza "1"), si dhe me trajtim përmes këmbimit të parcelës kadastrale nr.955-0 ZK Matëan, me pronar/ posedues PSH. KK Prishtinë, dhe të parcelave kadastrale nr.954-6, 833-5 dhe 833-22 ZK Matëan (Grupi "2"), si dhe me trajtim përmes këmbimit të pjesës së parcelës kadastrale nr.1411-1 ZK Matëan, me pronar / posedues PSH. Ujëra, sipas projekt propozimit konceptual & Planit të situacionit – "zgjidhja urbane", ka lëshuar gabime teknike, gjatë përshkrimit të numrit të parcelave kadastrale të trajtuara dhe të pronarëve / poseduesve të tyre, në tërë përbajtjen e aktit të lartcekur.

Poseduesit e vendimit të kushteve ndërtimore, në fazën e aplikimit në Drejtorinë e Pronës, për zhvillimin e procedurave të parapara në dispozitivët e vendimit të lartcekur, ka vërejtur disa gabime teknik të specifikuar në paragrafin II. të këtij vendimi, andaj, duke u bazuar në rregullativën ligjore, konkretisht në nenin 50 të LPPA-së, kjo drejtori vendosi që gabimet e lëshura ti korrigjojë sipas me këtë vendim, sipas përshkrimit në paragrafin II, të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi për korrigjim.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPH-së.

I dërgohet: Kërkuesve/investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndëve, 05nr.350/02 – 23500/23 dt.31.01.2023 dhe 05nr.350/02-52800/23 dt. 10.03.2023

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Planifikim Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 – 23500/23 DT.08.08.2024**

Zyrtari:
Ergyn Haxredini,



Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi,

